

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi kryetare, Ramiz Kuqi dhe Gani Avdiu, anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, NP “[D...]”, me seli në Obiliq, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.675/16, të datës 20.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 02.08.2019, merr këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit, N.P. “[D...]”, e dt.26.12.2018, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr.675/16, i datës 20.11.2018, **Vërtetohet**.

## **A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, N.P. “[D...]”, ka mbet në fuqi Vendimi nr.29/2016, i datës 25.03.2016, i Departamentit të Ankesave i Administratës Tatimore të Kosovës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të miratoj në tërësi ankesën e paditësit, të bëhet ndryshimi i Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.675/16, i datës 20.02.2018, ashtu që detyrohet Administrata Tatimore e Kosovës që paditësit ti kthej shumën prej 4.800 euro, në emër të tatimit të paguar pa bazë.

Gjykata e Apelit vlerësoi ligjshmërinë e Aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.h, të Ligjit,nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA-së), në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

### Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, e paditura me vendimin nr.29/2016, i dt.25.03.2016, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e nr.29/2016 të datës 26.01.2016 e tatimpaguesit NP “[D...]”, me NRB: “[...]” si dhe NRF: “[...]”, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, në lidhje me nenit 89 paragrafi 2, të Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim rivlerësimet e Tatimit Shtesë konfirmohen si të bazuara. Procedura e ankesës nuk ndërprejnë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit Nr.03/L-222.

I pakënaqur me vendimin e ATK-së, subjekti ushtron padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, në procedurë të konfliktit administrativ. Gjykata e shkallës së parë, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor të datës 20.11.2018, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të përfaqësuesit të paditurës, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa e lenë në fuqi vendimin e organit të paditur, sipas konkludimeve në arsyetim se; në procedurën e konfliktit administrativ gjyqësor, paditësi nuk i ka dëshmuar gjykatës provat materiale që kanë të bëjnë me prejardhjen e deponimeve bankare në bazë të cilave ka rezultuar tatimi shtesë. Paditësi nuk ka paraqitur librat e regjistrit, për të vërtetuar gjendjen që ka ekzistuar para kontrollit, edhe pse ka kundërshtuar vlerësimet e kontrollit se deponimet e gjetura nga transaksionet bankare, nuk e kanë burimin nga të ardhurat e tatueshme. Meqenëse paditësi nuk i ka bashkangjitur asnjë dokumentacion lëndës që ka të bëjë me të hyrat e realizuara përmes transaksioneve bankare, gjykata nuk ka mundur të pranohet konstatimet e paditësit se këto mjete janë deponuar me qëllim të marrjes së konfirmimit për vizë apo se këto mjete iu takojnë familjarëve. Në bazë të nenit 81.F paragrafi 1 të Ligjit 04/L-102, në këtë rast paditësi bart detyrimin mbi vërtetimin e fakteve që mbështesin kërkesën e tij. Nga këto prova të administruara gjykata konstaton se e paditura ka vepruar drejt kur me vendimin kontestues ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka konfirmuar si të bazuar Njoftim Rivlerësimet e kontrollit, me të cilat paditësi është ngarkuar me detyrime tatimore shtesë. Bazuar në provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nuk ka gjetur dëshmi që do të mund të ndryshonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja që ka konstatuar e paditura në procedurën administrative të ankesave dhe atë të kontrollit, për arsye se të hyrat nga deponimet bankare paditësi nuk ka qenë në gjendje t’i dëshmojë para gjykatës nga e kanë prejardhjen. Prandaj Gjykata e konsideron si të drejt aplikimin e metodës indirekte konform metodës indirekte konform nenit 30 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, ku është bërë llogaritja e detyrimit tatimor sipas metodës së depozitave bankare dhe shpenzimeve të keshit.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në prova dhe ligj, në tërësi e pranon edhe kolegji i kësaj gjykate. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të LKA dhe të LPK siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të cilat kolegji i heton sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar-vendimit të atakuar nga paditësi, si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në të cilin aktvendim në procedurë administrative e gjithashtu sipas aktgjykimit të ankimuar me ankesë, edhe në procedurë gjyqësore në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike e çështjes në shqyrtim, për arsye se evidencat e tatimpaguesit nuk kanë qenë të sakta dhe të besueshme prandaj, vlerësimi tatimor i ATK-së për paditësin, përmes aplikimit të metodave indirekte të vlerësimit, konform dispozitës së nenit 30 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010, është bërë llogaritja e detyrimit tatimor me Metodën e Depozitave Bankare dhe Shpenzimeve të Keshit, pasi që paditësi nuk i ka dokumentuar shpenzimet sipas nenit 15 par.5 të Ligjit nr.03/L-161 për TAP dhe neni 10 par.1 të Udhëzimit Administrativ.

Nga të lartë cekurat kolegji vlerëson se Gjykata e shkallës së parë dhe organi i paditur-ATK, kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore Njoftim Rivlerësimet e kontrollit me të cilat paditësi është ngarkuar me tatim shtesë për arsye se te hyrat nga deponimet bankare nuk ka qenë në gjendje ti dëshmoj nga e kanë prejardhjen.

Pretendimet ankimore të paditësit sipas shkaqeve të cekura më lartë, se gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të drejtë dhe nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore, si dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj, kolegji i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara dhe gjen se aktgjykimi nuk është i përfshirë me shkëlqje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, sepse e njëjta ka shqyrtuar padinë, ka mbajtur seancë të shqyrtimit kryesorë në praninë e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit e në mungesë të paditurës, si në vështrim të nenit 41 të LKA dhe në bazë të provave të administruara, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme si në vështrim të nenit 38 të LKA dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, bazuar në faktet dhe konkludimet e saj të paraqitura dhe shtjelluara si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore, ku sqarohet se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar, duke i lënë në fuqi vendimin 29/2016 të dt.25.03.2016.

Mbi këtë gjendje të fakteve Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë edhe organi administrativ përfundimtar ATK, drejtë kanë zbatuar dispozitat e LPK, LKA, dhe të Ligjit material për ATK-në, andaj aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë vërtetohet si i drejtë, i bazuar në prova dhe ligj.

Nga të lartcekurat, e në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 200 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**AA.nr.98/2019, me datë 02.08.2019**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Delushe Halimi**